

Mimoza PLLANA

Universiteti për Biznes dhe Teknologji, Kosovo

99 RRUZARET SMARAGDI: KOMUNIKIMI ME LEXUESIN**Mimoza PLLANA**

University for Business and Technology, Kosovo

99 EMERALD ROSARIES: COMMUNICATION WITH THE READER

99 emerald rosaries; a novel that stands out for its language with personal and im-personal references; a novel that creates from universal themes, harmonious with the life of the author, the people around him, with the real culture of Kosovar natives; is built by different types of characters, making them dynamic. The protagonist of novels is also the author and the people who tend to interact with him by connecting the texts with each other to create a whole story full of emotions. The author of the novel, Zejnullah Rrahmani, in the Albanian literature is known as an author who writes prose, short stories and novels; he deals with grand national topics, but also those overpass its boundaries by writing about life cycles, individual efforts towards a specific goal, love, coping with difficult situations, but also discovering the world around; from birthplace /village, to the city and new horizons, that are known as universal themes.

Keywords: autor, novelë, rrëfim, personazh.**Keywords:** author, novel, narrator, character.

“*99 rruzaret prej smaragdi*” kanë si referencë 99 mistere, 99 përjetime dashurie si 99 pafundësi/infinite, pastaj 99 emrat e Krijuesit (autori), të ndërlidhura me elemente reale dhe joreale për të krijuar rrëfimin më personal në prozë të shkrimtarit të njohur shqiptar, Zejnullah Rrahmani. Elementet reale bëhen të dukshme nëpërmjet personazhit Zen, shpeshherë protagonist e që në mënyrë organike krijon ndërlidhje në mes të personave në një familje. Lidhja organike krijohet në mes të një personi të quajtur *Zen që jetoi e vdiq*, një personi të quajtur *Zen që lindi e vdiq* dhe një personi të quajtur *Zen që vazhdon të jetojë*. Kjo trashëgimi emri shpjegohet në tekstin përkushtimor në hyrje të novelës:

*Këto shkrime të shpirtit ia kushtoj tim gjyshi Zenës,
Sadrisë, babës tim*

*Dhe vëllait tim Zenës që në fëmijërinë e
tij, si vetëtimë, ka kaluar rrugën e tij
nëpër kosmosin e jetës... (Rahmani 2016:4)*

Novela veçohet edhe për përfshirjen e temave universale, harmonike me njëra tjetrën, me kulturën reale, aktuale të qytetarëve kosovar, me peronazhët dinamik me emërtime konkrete e jokonkrete, me protagonistin e shumëfishtë, autorin, gjë që e bën veprën të dashur për lexuesin. Kjo vepër rikthen në tekst ngjarje nga një jetë e vështruar prej disa perspektivash: perspektivën e fëmiut, mësuesit, burrit, dashnorit, kalimtarit të rastit, qytetarit të një vendi të vogël padrejtësisht të mbetur në izolim dhe udhëtarit të botës.

Këtu, nëntë kapitujt: “*Esenca e dashurisë*”, “*Çdo gjë është e shkruar*”, “*Froni i esencës*”, “*Vera e përjetësisë*”, “*Koha*”, “*Velloja*”, “*Drita e tij*”, “*Lulet e mollës*”, “*Rrezja e dritës*” radhisin rrëfimet e lidhura me ndjenjën e dashurisë ndaj njeriut, ndaj vendit dhe Zotit, siç renditen një nga një rruazat në lutje.

Temat universale

Temat universale në novelë përfshijnë ciklet e jetës, përpjekjet individuale drejt një qëllimi, pastaj dashurinë, përballimin e situatave të rënda, por edhe zbulimin e botës: nga vendlindja/fshati drejt qytetit dhe horizonteve të reja. Njohja e horizonteve të reja, e rrëfyer nëpërmjet tekstit hap novelën “*99 rruazet prej smaragdi*”. Ky tregim i rrjedhshëm i mundëson lexuesit, përmes detajeve të veçanta të shprehura në një rend kohor, të bëhet pjesë e këndvështrimit të përcaktuar të autorit lidhur me temën e shumëtrajtuar në letërsi, tejkalimin e vendlindjes (fshati Ballofc) për në eksploruar *Dynjanë*:

Përtej shtëpisë së tim Ati u hap: teposhtë për në Fushë Kosovë.

Si një mjegullnajë drite atje lartë, në Ballofc.

Rrezet e para të diellit shpërthenin që prapa pu-llazeve të ultë të shtëpive të Bregut të Diellit dhe të Emshirit, ndërmjet rrokaqiejve të Ulpianës kishte dritë dhe terr.

Tutje, mezi dukej qielli i përhimtë.

Lart mbi maja të pyejeve, në Kënat, ende qëndronte një yll: Ylli im

Në të gjitha anët ishte Bota: e panjohur dhe e pakuptueshme.

Ishte Bota e pafund...

– Lamtumirë Shtëpi!

...Do të bredh këtu e tutue nëpër Dynja...

E gjetsha rrugën për t’u kthyer te Dashuria! (Rahmani 2016:5)

Tema universale e dashurisë natyrshëm mbizotëron tek novela. Ajo vjen si dashuri e papërcaktuar me një fjalë, ka më shumë shije. Atë e gjejmë të shprehur përmes veprimeve, mendimeve që përfshijnë dashurinë familjare, miqësore dhe dashurinë e pambarim e të pashlyer për gruan. Kjo e fundit rrëfëhet si një ndjesi që frymëzon personazhet, dhe në disa raste i shpie në çmenduri. Ajo vjen në disa

variante, shembull te tregimi “Lulet e Mollës”, ku dashuria e pazakontë lind në një shikim të papritur për t’u ndjerë si forcë që tejkalon të gjitha emocionet tjera:

Sytë i kishte të humbur! Gojën të hapur për të thënë diçka...Shikimi i tij shkoj e ram bi sytë ngashënjyes të vajzës së re dhe humbën aty në mrekulli të bukurisë femërore...

Ai nuk e kuptoj sa kishte zgjatur kjo bredhje nëpër thellësitë e dashurisë (studentët flisnin për disa çaste të një pushimi retorik, se ligjërata pastaj vazhdoj pothuajse me frymëzim të çuditshëm!).

Dashuria rrëfëhet edhe si fat tragjik, që zhvillohet jashtë vullnetit të njeriut. Pavarësisht pasionit, fati tragjik vjen si i caktuar paraprakisht nga fuqia e Zotit, sikur e kemi situatën në tregimin “Pasioni i pabesueshëm”:

Kur u dashuria ishte burrë në të tridhjetat.

Ajo grua e re, ndoshta as njëzet vjeçe, e martuar në mëhallë.

As një javë që Ajo erdhi nuse. Dhe, kur e pa atë në dritare, ajo ia mori pahinë hënës dhe bukurinë trëndafilil: veçse ia nxiu jetën menjëherë!

...Të nesërmen ia vrau burrin.

...Gjykatësi e dënoi me burg të përjetshëm që iu kthye në njëzet vjet burg...

Ditën e parë që doli nga burgu, mori rrugën drejt në shtëpinë e saj. Aty kishte njerëz dhe në oborr pa dërrasat e varrit: Ajo kishte vdekur atë mëngjes...dhi ai ra për toke aty, pa e njohur askush...

Ndërsa dashuria romantike rri në fokus ashtu si një strukturë narrative, lejon të zhvillohet një marrëdhënie për të cilën lexuesi ka interes ta ndjekë. Lidhja romantike midis dy personave shprehet si një fuqi mbizotëruese që tërheq të gjitha emocionet tjera dhe vëmendjen rreth e për qark.

Ajo befasisht hodhi flokët prapa dhe vështroi kah Zena. Ishtë një shikim që kapërceu lehtësisht terrin e natës dhe dritën e llambës që ndriçonte nga një dollap i hanit e papërfillur rrobat e trasha që kish veshur dhe shpërfilljen me të cilën qëndronte aty Zena, ai shikim i depërtoi deri në zemër dhe ajo u dridh me rrëmbim. Ai u befasuan aga ajo dridhje e përnjëhershme, pothuajse kërceu nga vendi sikur dikush ta qëllonte me thikë, e i tha me shikim “Pse”? Pse e bëre këtë?!

Temat me karakter universal, por me rrënjë në jetën shqiptare shtrihen gjerësisht në librin “99 rruzare prej smaragdi”. Përgjatë shtatë viteve të shkrimit të novelës në Otava të Kanadasë ku edhe jeton autori sot, kujtimet nga ngjarjet e shkuara japin pamje të reja përmes gjuhës e stilit të veçantë që e dallon prozatorin Rrahmani. Kjo delikatesë shkrimi rrjedh nga vetëdija e tij. Kështu deklaroi ai

tek tregimi “*Bukurshkrimi i dashurisë*”. Ky tregim vjen si dëshmi se rrëfimet e dashurisë janë produkte të gjuhës figurative dhe ritmike:

Ajo dashuri ishte shkruar me bukurshkrim të mrekullueshëm të gjithë tingujve (Rrahmani 2016: 44).

Pikërisht për mjeshtërinë stilistike, kritikët e rinj shqiptarë, Rrahmanin e vlerësojnë si një nga stilistët e mëdhenj të shekullit XX, duke theksuar se veçantia dhe fuqia themelore e gjithë veprës së tij është vetë stili i tij (Shala 2011: 219), i cili dallueshëm nga autori romantik e neoromantik tashmë e sheh veprën letrare si të vetmen qenie, si krijim bote për ta realizuar me figurë vdekjen e vet estetike (Krasniqi 2016: 638).

Gjuha referenciale

Nëse poetika merret me fjalën, me strukturën verbale që krijon veprën artistike, jo vetëm poezinë, atëherë në analizën e tekstit të kësaj novele, gjuha referenciale e shprehur me figurë dhe dretpërdrejt është një element që mesazhin e shkruar arrin ta kthejë në vepër arti.

Përveç novelës, diskursi në përgjithësi në romanet e Rrahmanit është vlerësuar se jeton në figura. Edhe kur teksti është referencial, figura është ajo që e mbyll referencialitetin në gjuhë dhe gjuha krijon botën fikzionale (Shala 2011: 202).

Në këtë kontekst, gjatë përpyekjeve për të krijuar komunikim nga një dekodim mesazhi i dhënë përmes funksionit poetik të gjuhës listojmë një lum fjalësh me kuptime të ndryshme në varësi të këndvështrimit të autorit për atë për të cilin/cilën ai flet:

Zena mori për detyrë të ushtronte meditimin...(Rrahmani 2016:137).

Aliu një ditë pa ëndërr të çuditshme: Gjithë natën hëna ishte zhdukur duke e lënë natën të ërrtë dhe të zezë (Rrahmani 2016: 283).

Ndonëse gjuha e veprës kryen funksionin referencial, vështirë se mund të përcaktohet vetëm si e tillë. Tekstet e shkruara për shtatë vjet e me rrëfime thuajse për një jetë, strukturën gjuhësore e kanë të ndërtuar mbi një diversitet funksional.

Personazhet

Emrat e personazheve janë konkret, kryesisht të përveçëm dhe me përshkrime reale, si: Fatimja, Hakiu, Aliu, Mihria dhe emra të tjerë që kryesisht i përkasin kulturës së emrave të fëmijëve kosovarë deri rreth viteve `70 të shekullit XX. Emrat jokonkretë, si: Fshesaxhiu, i Padrejti, Feniksi, kryesisht lidhen me cilësime bazuar në vlerat dhe veset e karaktereve fikcionalë. Ndërsa, personazhi Zen, emër konkret dhe i përveçëm është përdorur i shoqëruar me mbiemra, duke ofruar një përshkrim të gjallë të një burri me tipare të theksuara mashkullore, sipas vlerësimeve kulturore kosovare. Personazhët tjerë që vishen me tipare të caktuara, po ashtu të sjellin në mendje një figurë thuajse reale, shembull Fatimja: kurreshtare, shtatzënë, durimtare. Këto tri tipare bazike krijojnë imazhin e një gruaje të re, plot ëndrra dhe plane për

jetën që me durim pret të ndjejë dhembjen e ëmbël për të lindur fëmijën e saj. Ndërsa te Mihria dhe Hakiu, tiparet karakterizuese shënojnë cilësi të zhvillimit fizik dhe vrytje të karakterit të tyre, siç janë: sinqeritetit dhe besnikëria. Personazhet e kësaj novele kërkojnë një analizë në vete derisa janë produkt i përvojave të ndryshme të jetës, janë personazhë që zhvillohen nga përvojat e hidhura, personazhë që mvishen me sjellje të sinqerta, kërkues dhe fitimtarë ndaj sfidave, prandaj edhe janë të pëlqyeshëm për lexuesin. Poeti, prozatori, dramturgu, studiuesi i njohur i letërsisë shqipe, prof. Sabri Hamiti, në studimet e tij mbi veprën letrare të prof. Zejnullah Rrahmit, vlerëson se personazhet e romaneve janë shenja që përfaqësojnë idetë në lëvizje dhe në kërkim, janë funksione letrare në strukturën e veprës më tepër se karaktere letrare që imitojnë karakteret dhe zhvillimin e tyre në jetë (Hamiti 2002: 448).

Përmbyllje

“99 rruzaret prej smaragdi”, është vepra letrare e nënta me radhë e shkrimtarit të çmuar në letërsinë shqipe, Zejnullah Rrahmani. Romanin e parë, “Zanoret e humbura” (Rilindja, Prishtinë, 1974), Rrahmani e publikoi në moshë të re, dy vite pasi kishte mbushur njëzet vjet. Protagonist në këtë veprë është personazhi i quajtur Alban, e që në roman fillimisht prezantohet vetëm me tri bashtingëllore, ‘LB`N`’ dhe me shenjë apostrofi për tri zanoret “e humbura” A, A dhe I. Personazhi, Albani, është në kërkim të zanoreve të emrit të vet e që studiuesi Hamiti, këtë personazh e lexon si një simbol që paraqet idenë për kërkimin e identitetit kombëtar.

Novela, “Udhëtimi i një pik-uji” (Rilindja, Prishtinë, 1977) dhe romani “E Bukura e Dheut” (Rilindja, Prishtinë, 1977), të publikuara brenda një viti, janë të lidhura për temën e familjes në rrethana të caktuara kulturore, ndërsa *Sheshi i Unazës*, roman i publikuar për herën e parë më 1978 dhe varianti i ribotuar më 1982, karakterizohet me temat e mëdha të letërsisë, robërinë dhe lirinë. Në këtë linjë tematike, në vitin 1992, Rrahmani vjen për lexuesin shqiptarë me romani “Udhëtimi arbdhetar”. Tek ky roman rrëfimi ka si referencë personat historik, jetën dhe veprimet e tyre duke i futur në shkrimin autorial e të fiksonit (Shala 2011: 208). Gjatë kësaj dekade, publikohen edhe libri me tregime, “Mjeshtri i vetmisë”, (Prishtinë, 1995) dhe “Eurorilindja” (Tiranë 1995), më pas, në fillimshkullin e ri, vjen një nga romanet më të përmendura nga studiuesit e letërsisë shqipe, “Romani për Kosovën” (Prishtinë, 2000). “Romani për Kosovën”, rrëfen për situata të rënda nëpër të cilat u gjendën, jetuan e mbijetuan qytetarët shqiptarë të Kosovës, u perskutuan dhe përjashtuan por që s’u ndalën së kërkuari lirinë. Dhe më pas botohet romani, “Jusufo” (Dukagjini, Pejë, 2000), po ashtu në linjë me romat tjera që kanë për temë atdheun. Pas këtij romani, vjen vepra letrare më personale e Rrahmanit, “99 rruzaret prej smaragdi” (Faik Konica, Prishtinë, 2006) për të cilën prezantuar disa mendime pas leximit e rileximit të saj.

Zejnullah Rrahmani, ende nuk ka mbyllur krijimtarinë e tij letrare, prandaj kujtojmë edhe botimet e radhës, si: prozën poetike, “Iluminacion” (Otava, 2008), tregimet dhe novelat, “Tregimet e Ballofcit” (Faik Konica, Prishtinë, 2008), dhe dy veprat e kësaj dekade, po ashtu të shkruara në prozë, si forma më e dashur e shkrim-

it për këtë autor, “*Lypësi dhe Sophia*” (Faik Konica, Prishtinë, 2011) dhe “*Pesë vakte*” (Faik Konica, Prishtinë, 2013). Sigurisht, si lexuesit e pasinuar të veprës së Rrahmanit, presim librat e rinjë.

BIBLIOGRAFIA // BIBLIOGRAPHY

Shala 2011: *Shala, K.* Prolepsa, AIKD-99, 2011, Prishtinë.

Krasniqi 2016: *Krasniqi, N.* Letërisa e Kosovës 1953–200, AIKD-99, 2016, Prishtinë.

Hamiti 2002: *Hamiti, S.* Vepra letrare 9, FAIK KONICA, 2002, Prishtinë.

Rrahmani 2006: *Rrahmani, Z.* 99 rruzaret prej smaragdi, Faik Konica, 2006, Prishtinë.